



Pranimi / Dorezimi Prilbena / Protokol Recepçioni / Dohetevy	01-04	2022	2	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednitca Org / Unit	Hi / Pret Bi / Pret Prot No	Shtopa Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SK/MSH/CIC	1787/2022		115	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.141/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.141/2022 të datës 18.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] Prishtinë, kundër organit të punësimit/Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, në çështjen juridike “Vlerësimi i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 01.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.141/2022 e datës 18.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën “Menaxher i Prokurimit ” sipas Akt emërimit të datës 02.04.2013 në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, më datë 04.02.2022 ka parashtruar ankesë te Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 31.01.2022. për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, me notën e përgjithshme 1.95.

Ankuesi meqenëse nuk ka marr përgjigje, nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, më datë 18.02.2022 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit zyrtar me numër protokolli 844/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 18.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, ndërsa me datë 03.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.141/2022 me numër të protokollit 844/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 18.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 18.02.2022 me numër protokollit 844/2022; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm , i Ulët dhe Profesionale; Ankesë e datës 04.02.2022 e parashtruar për Kryeshefin Ekzekutiv i Arkivit të Kosovës lidhur me vlerësimin në punë; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm , i Ulët dhe Profesionale për vitin 2021; Përgjigje në kërkesë e datës 03.03.2022 me numër protokollit 1133/2022 bashkë me shkresat e lëndës; E-mail zyrtar i datës 02.03.2022; Akt emërimi i ankuesit i datës 02.04.2012; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Menaxher i Prokurimit; Vërejtje me shkrim për Menaxher i Prokurimit; E-mail zyrtar i datës 01.03.2022; Letër përcjellëse e datës 02.03.2022 nga Drejtori Ekzekutiv i ASHAK-së; E-mail zyrtar i datës 14.09.2021; Deklaratë për keqpërdorim të materialit të mbetjeve për shitjen e metaleve , pajisjeve të IT dhe inventarit për zyrë. Kërkesë e datës 22.02.2022 përmes e-mailit zyrtar E-mail zyrtar i datës 21.02.2022; E-mail zyrtar i datës 30.03.2022; Plani i prokurimit për vitin 2021 dhe Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.02.2022 ka theksuar që është i pakënaqur me formularin e vlerësimit për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021 të cilin e ka nënshkruar me datën 31.01.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të cilin e ka bërë Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës ka pasur parregullsi dhe asnjëherë nuk jam ftuar për të diskutuar rreth vlerësimit ashtu siç përcaktohet në Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm, sepse vlerësimi i rezultateve në punë nga Kryeshefi Ekzekutiv është bërë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, dhe se nga shkresat e lëndës shihet se ka pasur komunikim dhe takim në mes kryeshefit dhe ankuesit dhe kanë diskutuar çështje që lidhen me objektivat e përbashkëta, ndërsa nga ankuesi nuk ka konkretizuar ndonjë fakt të qëndrueshëm që e bënë të besueshëm pretendimin se ka pasur parregullsi dhe se nuk janë takuar për të diskutuar çështje që lidhen me planifikimet e përbashkëta.



Pretendim tjetër ankimor i ankuesit është se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 nga Kryeshefi Ekzekutiv është bërë në formë hakmarrje duke shfrytëzuar pozitën që ka dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se kanë qenë disa komunikime zyrtare që lidhen me përgjegjësit institucionale dhe poashtu vërtetohet se kemi dështim të disa proceseve tenderuese, sipas listës që është ofruar nga organi i punësimit, por se nga ankuesi nuk është arrit që të ofrohet ndonjë dëshmi që e heq përgjegjësin e dështimit të këtyre proceseve tenderuese, andaj kolegji vlerëson se ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Poashtu ankuesi pretendon se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 është bërë në formë hakmarrje pasi që i njëjti kryeshefin e tij e ka lajmëruar në organet kompetente të Republikës së Kosovës për sjelljet jo të ligjshme dhe ndikimet e paligjshme në procedurat e tenderimit". Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse ankuesi me asnjë provë nuk ka dëshmuar se Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës ka pasur sjellje jo korrekte me menaxherin e prokurimit dhe nuk është argumentuar me asnjë provë të ndonjë ndikimi direkt në procedurat e tenderimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin ankimor të ankuesit se nuk pajtohet me këtë vlerësim duke konstatuar i njëjti se gjatë punës së tij për vitin 2021 nuk ka marrë asnjë vërejtje nga institucionet relevante si KRPP-ja, OSHP-ja, AQP-ja, Auditorët dhe institucionet tjera relevante .Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të provave të cilat i posedojmë nga organi i punësimit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse në provat e lëndës, kemi një listë të datës 05.01.2022 të dërguar nga organi i punësimit të aktiviteteve të parapara me planin e prokurimit të vitit 2021 të cilat nuk janë realizuar e të cilat janë : Procedura të anuluarat e prokurimit, procedura që ende janë në OSHP, procedura të prokurimit të porealizuara : ridizajnimi i Eëb faqës; loga e ASHAK-së, larja e automjeteve, deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi i arkivave ndërkomunale, kjo listë është nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, si dhe poashtu kolegji me rastin e shqyrtimit të këtij pretendimi pati parasysh edhe vlerësimin e vitit paraprak.

Kolegji bazuar në konstatimet e mësipërme ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1.Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit.....dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për**

realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar)., rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi me asnjë provë nuk ka arritë të dëshmojë se është realizuar plani i punës konformë objektivave të dakorduara dhe se poashtu nga shkresat e lëndës që janë ofruar nga palët, e specifikisht nga ankuesi, me asnjë provë nuk ka arritë të provojë faktin se ai si Menaxher i Prokurimit në këtë institucion nuk ka përgjegjësi për dështimin e realizimit të disa planifikimeve në fushën e prokurimit për vitin 2021 dhe se nuk është ofruar asnjë provë relevante që i njëjti ka bërë përpjekje që të realizohen këto planifikime ashtu si ishin planifikuar, andaj bazuar në këto rrethana si dhe duke marrë parasysh komunikimet që ankuesi ka pasur me udhëheqësin e tij, Kolegji vlerëson se i njëjti nuk ka arritur ti kryej dhe përmbushë objektivat konformë planifikimeve.

Andaj kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara sepse Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për menaxherin e prokurimit e ka bërë në bazë të objektivave të punës të realizuara dhe e ka vlerësuar me notën 1.95 që nënkupton "kënaqshëm" ose "mjaftueshëm" konformë nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ,e në kuptim të nënparagrafit 2.4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: 2.4. "kënaqshëm ose mjaftueshëm", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit". Andaj, nisur nga konstatimi si me lartë se ankuesi nuk ka përmbushur objektivat e punës mjaftueshëm sipas pritjeve, Kolegji vlerëson se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.141/2022, datë 01.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

